



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MBLEDHJE E BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë më 04.06.2018

**Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 04.06.2018
shqyrtoi çështjet si më poshtë :**

1. Në lidhje me liçensimin e shoqërinë “SONNE” shpk, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë me fuqi të instaluar 1998 KW, për një afat 20 vjeçar.
2. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “BLAC ENERGY” sh.p.k, për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “BLAÇ”, me fuqi të instaluar 1300 MW, për një afat 30 vjeçar.
3. Relacion mbi fillimin e procedurave për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2018 dhe Planit 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë ALBGAZ sha.
4. Mbi fillimin e procedurave për transferim e licencës së Operimit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a), miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 08.07.2016 tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a (FSHU sh.a), e vlefshme deri më datë 08.07.2021.
5. Mbi fillimin e procedurave për transferim e liçencës së Operimit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sha (OSHEE sh.a), me nr.licence 250, seria P14SH, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr.96 Date 27.10.2014, tek shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a (O.S.SH sha), e vlefshme deri më datë 27.10.2044.

6. Mos fillimin e procedurës, për modifikimin e liçencës së shoqërisë “Garvan Energy” shpk, nr. 349 liçence, seria PV16K, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 140, datë 15.08.2016, për prodhimin e energjise elektrike, nga Hec-et “Gavran 1”.
7. Liçensimin e shoqërisë “AED Solar ”sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik -Topojë me fuqi të instaluar 1998 kW, për një afat 20 vjeçar.
8. Liçensimin e shoqërisë “Wind Power Albania” shpk, në aktivitetin e Furnizimit te Energjise Elektrike.
9. Miratimin e Kodit te rrjetit për kërkesat e lidhjes me rrjetin të sistemeve me tension të lartë me rrymë të vazhduar dhe parqet me module të energjisë të lidhur me rrymë të vazhduar (HVDC), Kodit e rrjeti mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin të gjeneruesve, Kodit e rrjetit për ngarkesën.
10. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencim të shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a, në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
11. Inforomacion mbi kërkesën e shoqërisë MP-HEC sh.p.k për shtyrje të afatit të Vendimarrjes.